



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE
SEKTORI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, RINISË DHE SPORTEVE

Nr. 18247 Prot

Lezhë, më 23.09.2026

NJOFTIM

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË APLIKIMIT PËR PËRFITIM TË BURSËS NGA NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, PËR VITIN SHKOLLOR 2026-2027.

Mbështetur në VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” i ndryshuar, njoftojmë të gjithë nxënësit, prindërit apo kujdestarët ligjorë të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar publik në territorin e Bashkisë Lezhë, se ka filluar procedura e aplikimit për përfitim të bursës për vitin shkollor 2026-2027. Dokumentat dorëzohen pranë institucionit arsimor ku është i regjistruar nxënësi. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet në varësi të kriterit që plotëson nxënësi janë sipas Shtojcës Nr.1 bashkëngjitur këtij njoftimi

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave është **DATA 30 TETOR 2026.**

Për çdo informacion të mëtejshëm, lutemi t’i drejtoheni institucionit arsimor ku është i regjistruar nxënësi.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Reinis CELLA



**KRYETARI
Pjerin NDREU**